

Në bazë të raportit nga personat zyrtar dhe deklaratave zyrtare nga Delegati i ndeshjes z. **Ardian Ibraj**, KV “Peja”, referi **Elmi Zymeri** dhe lojtari i KV “Peja” **Leotrim Mujaj** pas hapjes së procedurës disiplinore nga komesari i garave për ndeshjen finale të Kupës së Kosovës në mes të KV “Ferizaj” – KV “Peja” konkurenca e Meshkujve zhvilluar me datë 31.03.2024 me fillim në ora 17:15 në Prishtinë, bazuar në Rregulloren për Procedurën dhe Masat Disiplinore të FVK-së, komisioni disiplinor pas konsultave në takimin e mbajtur me datë 04.04.2024 në ora 17:30 merr këtë:

V E N D I M

1. Lojtarit **Leotrim Mujaj**, KV “Peja”, i shqiptohet masa disiplinore mosparaqitje në 2 (dy) ndeshje si dhe dënimi me të holla prej 200.00€ (dy qind euro) në bazë të Aneksit 1 të rregullores disiplinore, pjesa Shkeljet dhe Dënimet Për Pjesëtarët e Ekipeve, pika 4 dhe 6.

Arsyetim: Gjatë marrjes së vendimit janë shqyrtuar deklaratat e akterëve në këtë ndeshje, Personat zyrtar, referi i parë dhe KV “Peja” si dhe xhirimi në momentin e aktit ku shihet goditja e mbrojtëses së karrikës së referit dhe reagimi i tij me nervozizëm në drejtim të tavolinës zyrtare.

Si masë lehtësuese është marrë reagimi i anëtarëve të klubit të KV “Peja” në qetësimin e tij si dhe kërkimfalja menjëherë pas përfundimit të ndeshjes akt i cili është marrë si pendim për sjelljen e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi lejohet ankesa brenda 15 ditëve nga dita e pranimt të këtij vendimi në shkallë të dytë (Komisionin e Ankesave).

Ankesa e ushtruar nga ana e palës së ankimuar nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit, kurse afati për pagesën e gjobave është 5 ditë nga data e marrjes së vendimit.

Komisioni Disiplinor:
Gëzim Brahimi
Driton Ramadani
Liridon Dalipi

Prishtinë
Me 04.04.2024

